



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.03.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4654/16, për z. Ahmet Krasniqi, Anëtar I Bordit në Kompaninë Rajonale të Mbeturina "Pastërtia" në Ferizaj, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Ahmet Krasniqi, Anëtar i Bordit në Kompaninë Rajonale të Mbeturina "Pastërtia" në Ferizaj dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar) në biznesin privat Milenium Production, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimi të kësaj shkrese kemi njoftuar me fakte zyrtarin e lartë se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragrafi 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Prandaj, Agjencia kundër Korrupsionit i ka kërkuar zyrtarit të lartë të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial në biznes privat, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, është deklaruar se do të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial në biznes privat, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/636/17)), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në biznesin privat Milenium Production. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

